

KUSHTET E PËRGJITHSHME

OBJEKTI I SIGURIMIT

Objekt i kësaj kontrate është sigurimi i përgjegjësishë të drejtuesit të mjetit motorik, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me një mjet me regjistrim të huaj, për dëmet që ky drejtues mund t'i shkaktojë palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, si rrjedhojë e veprimeve ose mosveprimeve të tij me faj, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 32/2021, datë 16.03.2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

Kjo kontratë sigurimi mbulon përgjegjësinë e të siguruarit ndaj palëve të treta për dëme të ndodhura vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Llogaritja e masës së dëmshpërblimit ndaj palëve të treta, për detyrimin që buron nga kjo policë sigurimi, për

dëmin e shkaktuar në një aksident, kryhet vetëm mbi bazën e ligjit nr. 32/2021 datë 16.03.2021 "Për sigurimin e

detyrueshëm në sektorin e transportit" dhe Rregullores së lëshuar nga Autoriteti në zbatim të ligjit.

2. Drejtuesit e mjeteve të përfshirë në një aksident rrugor, për dëmet ndaj pronës në vlerë deri në 30 000 (tridhjetë

mijë) lekë, nëse bien dakort duhet të plotësojnë, të nënshkruajnë dhe të shkëmbejnë Raportin European të Aksidenteve, pa patur nevojë që të kenë procesverbalin e konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore. Për dëme ndaj pronës deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, vetëm në rastet kur drejtuesit e mjeteve të përfshirë në aksident nuk bien dakord, si dhe për të gjitha dëmet e pronës mbi këtë vlerë duhet të marrin procesverbalin e konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore.

DISPOZITA TË TJERA

3. I Siguruari është i detyruar të njoftojë Rastin e Sigurimit menjëherë por jo më vonë se 72 orë nga momenti i

ndodhjes së tij ose nga dita në të cilën ka marrë dijeni, pranë shoqërisë së sigurimit.

4. Në zbatim të nenit 9, 10 të Ligjit nr. 32/2021, datë 16.03.2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e

transportit", pas trajtimit dhe marrjes së përgjigjes nga shoqëria e sigurimit/Byroja, pala e dëmtuar që ka pretendime, mund t'i drejtohet gjykatës me padi civile.

5. Pala e dëmtuar i drejtohet me kërkesë për dëmshpërblim drejtpërdrejt shoqërisë së saj të sigurimit, në rastin kur

shkaktari i aksidentit është i pasiguar apo i paidentifikuar, mbi çdo dëm të shkaktuar mbi pronën apo shëndetin e

tij.

6. Afati i parashkrimit të palës së tretë të dëmtuar për kërkimin e dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit është 2 vjet

nga dita e ndodhjes të aksidentit në bazë të nenit 115 shkronja ç) të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

7. Të dhënat personale të mbledhura nëpërmjet kësaj (emri i policës së sigurimit të detyrueshëm) do të përdoren në administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënien e shërbimeve ndaj të siguruarit dhe

përfituesit, përfshirë trajtimin e dëmit, në zbatim të ligjit nr.32/2021, datë 16.03.2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e




transportit".

Shoqëria e sigurimit (emri i shoqërisë) realizon transferimin e të dhënave personale tek të tretë për qëllime të sigurimit apo biznesit sipas specifikimeve të ligjit. Në lidhje me të dhënat personale të mbledhura dhe përpunimin e tyre, klienti ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e aksesit dhe të drejtat e tjera të parashikuara në ligjin nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar).

Verifikoni policën tuaj të sigurimit kufitar në Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në faqen web të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare www.amf.gov.al ose duke kontaktuar në konsumatori@amf.gov.al.

RAPORTI EVROPIAN I AKSIDENTEVE

Ky formular i nënshkruar nga të dy drejtuesit e mjeteve konsiderohet i vlefshëm dhe përdoret për dëshmipërblimin e shpejtë në rast të aksidenteve rrugore nëse ka dëme ndaj pronës në vlerë deri 30 000 (tridhjetëmijë) lekë.

1. Data e aksidentit Ora _____	2. Vendi i aksidentit (rrethi, qyteti, adresa)	3. Dëme shëndetësore Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
4. Dëme materiale mjeteve të tjera përveç A ose B: Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> *	5. Dëshmitarë: emër, mbiemër, adresa, tel. (saktëso nëse janë pasagjerë në mjetin A ose B). Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nëse po, plotëso mbrapa	
Mjeti A (i dëmtuar)		Mjeti B (shkaktar)
6. I siguruari (kontrollo policën e sigurimit) Emër _____ Mbiemër _____ Adresa _____ Shteti _____ Email _____ Tel. _____ 7. Automjeti Marka dhe tipi _____ Targa ose nr. i shasisë _____ 8. Shoqëria e sigurimeve _____ Nr. i Policës _____ Nr. i Kartonit Jeshil _____ (për të huajt) (sigla e vendit) (nr.) _____ Kontrata e sigurimit e vlefshme deri ose Kartoni Jeshil _____ A është vetë mjeti i siguruar (Kasko) ? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> 9. Drejtuesi (Kontrollo dokumentet) Emër _____ Mbiemër _____ Adresa _____ Shteti _____ Tel. email _____ Leje drejtimi nr. _____ Kategoria _____ lëshuar nga _____ më _____ E vlefshme deri më _____ 10. Shëno me kryq pikën fillestare të goditjes.	A 12. Rrethana të aksidentit Vendos një "X" në secilën nga kutitë që përshkruan aksidentin 1 I ndaluar/I parkuar 2 nisej pas një ndalimi 3 përpiquej të ndalonte 4 dilte nga parkimi, vend privat ose rrugë me përdorim privat 5 hynte në parkim, vend privat ose rrugë me përdorim privat 6 hynte në një shesh me kah rrotullues 7 qarkullonte në një shesh me kah rrotullues 8 godiste një mjet, që ecte në të njëjtin drejtim dhe në të njëjtën rradhë 9 godiste një mjet, që ecte në të njëjtin drejtim, por në rradhë tjetër 10 ndërronte kors 11 parakalonte 12 kthehej djathtas 13 kthehej majtas 14 ecte mbrapsht 15 qëndronte aty ku kalonte sensi i kundërt 16 vinte nga e djathta 17 nuk kishte vënë re shenjat e përparësisë apo semaforin e kuq Shëno në kuti numrin total të kryqeve të vendosura më lart ← _____ →	B 6. I siguruari (kontrollo policën e sigurimit) Emër _____ Mbiemër _____ Adresa _____ Shteti _____ Email _____ Tel. _____ 7. Automjeti Marka dhe tipi _____ Targa ose nr. i shasisë _____ 8. Shoqëria e sigurimeve _____ Nr. i Policës _____ Nr. i Kartonit Jeshil _____ (për të huajt) (sigla e vendit) (nr.) _____ Kontrata e sigurimit e vlefshme deri ose Kartoni Jeshil _____ A është vetë mjeti i siguruar (Kasko) ? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> 9. Drejtuesi (Kontrollo dokumentet) Emër _____ Mbiemër _____ Adresa _____ Shteti _____ Email _____ Leje drejtimi nr. _____ Kategoria _____ lëshuar nga _____ më _____ E vlefshme deri më _____ 10. Shëno me kryq pikën fillestare të goditjes.
	13. Grafiku i aksidentit Tregoni: 1) planin e rrugëve; 2) drejtimin e udhëtimit të A e B; 3) pozicionin e tyre në momentin e përplasjes; 4) shenjat rrugore; 5) emrat e rrugëve 	
11. Dëme materiale të dukshme. _____ _____ _____	15. Firmat e të dy drejtuesve A _____ B _____	11. Dëme materiale të dukshme _____ _____ _____
14. Vërejtje _____ _____	14. Vërejtje _____ _____	14. Vërejtje _____ _____

* Nëse ka dëme materiale në objekte të ndryshme, përveç automjeteve A dhe B, përshkruani në rrethanat e aksidentit.

Raporti nuk duhet korrigjuar dhe duhet të bashkëngjiten dokumentat siç sqarohen në pjesën mbrapa.

Informacione të tjera/Kërkesë për dëmshpërblim

TË PLOTËSOHET NGA TË SIGURUARIT DHE TË NJOFTOHET SIGURUESI PËRGJEGJËS BRENDA 5 DITËVE NGA NDODHJA E RASTIT TË SIGURIMIT

Emri i të siguarit (i dëmtuari) _____ nr. telefoni _____ email _____
Siguruesi përgjegjës (shoqëria që ka lëshuar policën e shkaktarit të dëmit) _____
Rrethanat e aksidentit (përkrahë të gjitha rrethanat e ndodhjes së aksidentit)

Dëshmitarët

Nr.	Emër Mbiemër	Adresa	Telefoni	Statusi (pasagjer ose jo)

Në _____ më ____/____/_____

Nënshkrimi i të siguarit (i dëmtuari)

Kujdes! Të përdoret për aksidentet rrugore nëse ka dëme ndaj pronës të cilat konsiderohen në vlerë deri 30 000 (tridhjetëmijë) lekë. Plotësimi i këtyre të dhënave konsiderohet **kërkesë për dëmshpërblim**, e cila shoqërohet dhe me dokumentat si më poshtë:

- Fotografi në momentin e aksidentit para lëvizjes së mjeteve nga një distancë e afërt dhe e largët (dëmtimin e mjeteve, gjurmët e frenimit, mbeturinat e rëna në rrugë) dhe gjurmët e rëndësishme si pozicioni i mjeteve, i rrotave etj.
- Fotografi të mjeteve të dëmtuara në mënyrë të qartë, pjesët e dëmtuara dhe targën e mjeteve;
- Dokumentat e identifikimit të palëve të përfshira në aksident (ID);
- Dokumentat e mjeteve dhe drejtuesve të tyre (leje qarkullimi, leje drejtimi, kopje e policave të sigurimit).

Kujdes! Mungesa e fotografive kërkon ekspertizën e mjetit të dëmtuar nga ana e shoqërisë së sigurimit përgjegjëse. Rekomandojmë që Raportin Evropian të Aksidentit ta mbani në automjetin tuaj.

Si duhet vepruar në rast aksidenti?

Në rast se dikush ka humbur jetën apo është lënduar, qoftë edhe lehtë, njoftoni menjëherë Institucionet Shëndetësore në Nr. Tel. 112 dhe Policinë e Shtetit në Nr. Tel 127.

Sido që të jenë rrethanat, ruani gjakftohtësinë, qëndroni korrekt dhe plotësoni qetësisht e me kujdes së bashku me drejtuesin tjetër këtë Raport Evropian të Aksidentit.

Plotësimi i formularit në vendin e aksidentit:

1. Përdorni vetëm një Raport Evropian të ngjarjes për 2 mjete në secilin rast (2 për 3 mjete, etj). Pak rëndësi ka kush e jep vërtetimin miqësor dhe kush e plotëson atë. Preferohet të përdorni një stilolaps për të shkruar dhe shkruani në mënyrë të tillë që kopja të jetë plotësisht e lexueshme. Ky formular përdoret për trajtimin e një kërkesë për dëmshpërblim vetëm pranë një shoqërie sigurimi.
2. Gjatë plotësimit të Raportit Evropian të Aksidentit për t'iu përgjigjur pyetjeve të rubrikave, mbani parasysh si më poshtë:
 - a. në rubrikën 8 përdorni dokumentat tuaja të sigurimit (kontrata e sigurimit ose kartoni jeshil);
 - b. në rubrikën 9 përdorni lejen tuaj të drejtimit (patenta e shoferit);
 - c. në rubrikën 10 tregoni me saktësi pikën e goditjes fillestare;
 - d. në rubrikën 12 vendosni një kryq (x) në kuti në drejtim të secilës prej rubrikave të rrethanave (nga nr. 1 deri në nr. 17), që i përkasin aksidentit dhe tregoni gjithashtu numrin e shkaqeve të nënvizuar;
 - e. në rubrikën 13 bëni një skicë të aksidentit.
3. Nënshkruani së bashku me drejtuesin e mjetit tjetër Raportin Evropian të Aksidentit.
4. PAGESA E DËMIT NGA SHOQËRIA E SIGURIMIT SIPAS RAPORTIT EVROPIAN TË AKSIDENTIT, SHUAN DETYRIMIN E SHOQËRISË PËR pretendime të tjera lidhur me vlerën e dëmit.
5. Depozitoni këtë dokument pa vonesë **brenda 5 ditëve** nga data e aksidentit, tek siguruesi përgjegjës.